

AKT THEMELIMI

SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"BlueSpot"

Sot, në **Tiranë**, më datë **25.12.2024**, unë **Znj. Pamela Pëllumbi**, e bija e Shaqir dhe Ajete, lindur në Kuçovë, e datëlindjes 08.10.1998, me nr.personal J86008038Q, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe me gjendje civile beqare, me dëshirë të lirë dhe me vullnet të plotë e të pavesuar, deklaroj se kam hartuar aktin e themelimit të shoqërisë **"BlueSpot"**, bazuar në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar, dhe ligjin nr.131/2015 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".

NENI 1 - FORMA E SHOQËRISË

Formohet një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (**sh.p.k**), që ushtron aktivitetin e saj sipas objektit në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

NENI 2 - EMRI I SHOQËRISË

Emri i shoqërisë është **"BlueSpot"**. Ky emër është i lirë, nuk është i regjistruar, apo i bllokuar në regjistrin tregtar.

NENI 3 - ORTAKËT E SHOQËRISË

Shoqëria "BlueSpot" themelohet dhe krijohet si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me 1 (një) ortak. Ortaku i vetëm i shoqërisë "BlueSpot" është:

- 1. Znj. Pamela Pëllumbi**, e bija e Shaqir dhe Ajete, lindur në Kuçovë, e datëlindjes 08.10.1998, me nr.personal J86008038Q



NENI 4 - SELIA E SHOQËRISË

Selia e shoqërisë "BlueSpot" ndodhet me adresë: "Tiranë, Njësia Administrative Nr. 13, Rruga "Hamdi Sina", Pallati Rinia 04, Kati 0".

NENI 5 - OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Shoqëria "BlueSpot" ka si objekt të veprimtarisë së saj, por pa u kufizuar, si vijon:

Krijimi, zbatimi dhe integrimi i sistemeve të menaxhimit të parkimeve dhe programeve kompjuterike të lidhura me to. Ndërtimi dhe instalimi i sistemeve të kontrollit të aksesit dhe sigurisë fizike, përfshirë kamerat për njohjen e targave të makinave, portat automatike, makinat e biletave dhe kioskat e pagesave për menaxhimin efektiv të hyrjeve dhe daljeve të parkimeve. Importimi, eksportimi dhe tregtia e pajisjeve dhe programeve në fushën e teknologjisë së informacionit, si dhe sigurimi i mirëmbajtjes dhe riparimeve të sistemeve të instaluar. Ofrimi i konsulencës dhe shërbimeve të personalizuar për projektim, instalim dhe mirëmbajtje të sistemeve të parkimeve inteligjente dhe të sigurta. Krijimi, organizimi dhe operimi i kurseve profesionale dhe trajnimeve për përdoruesit dhe administratorët e sistemeve. Menaxhimi dhe operimi i sistemeve të parkimeve, duke përfshirë shitjen online dhe integrimin me sisteme të tjera të transportit dhe menaxhimit urban. Importimi, eksportimi dhe tregtia e pajisjeve për karikimin e automjeteve elektrike, si dhe ofrimi i konsulencës dhe shërbimeve për projektim, instalim dhe mirëmbajtje të sistemeve të karikimit të automjeteve elektrike. Kryerja e importimit, montimit, mirëmbajtjes, riparimit, menaxhimit, projektimit dhe konsulencës për sisteme inteligjente të transportit, menaxhimin e trafikut, mbledhjen e tarifave, teknologjitë e qytetit inteligjent, sinjalizimin e trafikut, menaxhimin e parkimeve, sistemet qendrore të të dhënave dhe kontrollit, rrjetet, matjen e peshës, kontrollet elektronike, leximin dhe klasifikimin e targave të automjeteve, impiante portash automatike, bllokues trafiku, barrierash dhe kontrollit të dedikuar, impiante kundër grabitjes, zjarrit, permbytjeve dhe gazrave, impiante për transmetim të të dhënave dhe telekomunikacioni. Shërbime të kontrollit të aksesit në ambiente të ndryshme si zyra, institucione publike apo private, organizata, banka, qendra tregtare, shkolla, spitale dhe objekte të tjera sipas nevojave të personave apo shoqërive të interesuara. Çdo aktivitet tjetër që lidhet drejtpërdrejt ose indirekt me objektin e veprimtarisë së kompanisë, në përputhje me legjislacionin dhe normat në fuqi në Republikën e Shqipërisë.



NENI 6 - KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë fillon nga data e regjistrimit në regjistrin tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe është **e pakufizuar**.

NENI 7 - KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali bazë fillestari i shoqërisë "BlueSpot" është **100.000 (një qind mijë) lekë** dhe deklarohet tërësisht i paguar nga ortakët i vetëm i shoqërisë në kapitalin e shoqërisë.

Kapitali i shoqërisë "BlueSpot" përbëhet nga **1 (një) kuotë**, e cila ka vlerën dhe përfaqëson 100% të kapitalit të shoqërisë, si më poshtë vijon:

- a) Znj. Pamela Pëllumbi zotëron pronësinë e Kuotës I, e cila përfaqëson 100% të kapitalit të shoqërisë "BlueSpot"**

NENI 8 - ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

Organet e shoqërisë "BlueSpot" janë si vijon:

- 1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve
- 2. Administratori

NENI 9 - ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Shoqëria "BlueSpot" administrohet nga:

- 1) **Znj. Pamela Pëllumbi**, e bija e Shaqir dhe Ajete, lindur në Kuçovë, e datëlindjes 08.10.1998, me nr.personal J86008038Q, e cila ka afat 5-vjeçar.

NENI 10 - PËRFAQËSIMI I SHOQËRISË

Kufizimet e tagrave të përfaqësimit të administratorit i kundrejtohen palëve të treta, në përputhje me ligjin. Administratori, i cili përfaqëson shoqërinë tregtare, mund të autorizohet për kryerjen e disa veprimeve të caktuara apo për kryerjen e disa kategorive të caktuara veprimesh. Përfaqësimi ligjor i shoqërisë (i drejtpërdrejt ose i deleguar me autorizim) është i vlefshëm për çdo veprim gjyqësor apo jashtëgjyqësor. Veprimet e kryera nga përfaqësuesi ligjor i shoqërisë (i drejtpërdrejt ose i deleguar me autorizim) janë të



detyrueshme për shoqërinë edhe nëse këto tejkalojnë objektin e saj, me përjashtim të rastit kur këto veprime shkojnë përtej tagrave të përfaqësimit që u jep ligji apo lejon t'u jepet përfaqësuesve. Këto veprime nuk janë detyruese për shoqërinë, nëse shoqëria provon se i treti ka patur dijeni se akti tejkalon objektin e saj, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte patur dijeni për të. Njoftimet e drejtuara administratorit janë të vlefshme e detyruese për shoqërinë. Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim njoftohet për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Të gjitha shkresat, formularët e urdhrave, apo çdo dokument tjetër korrespondencë, nxjerrë nga shoqëria, degët ose zyrat e përfaqësimit, nëpërmjet përdorimit të letrës apo mjeteve elektronike, të cilat u drejtohen palëve të treta, do të përmbajnë të dhënat e mëposhtme: numrin unik të identifikimit, formën ligjore të shoqërisë, vendndodhjen e selisë së regjistruar dhe zyrës qendrore, numër kontakti, e-mail, faqe internet (nëse ka).

Çdo gjë tjetër më e detajuar parashikohet në statutin e shoqërisë, kopje e të cilit do të depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit, dhe/ose në legjislacionin shqiptar në fuqi për këtë qëllim.

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË

"BlueSpot"

Pamela Pëllumbi

Pamela Pëllumbi

